



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 08.08.2023 kundër dosjes së tenderit të datës 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. e datës 08.08.2023 kundër dosjes së tenderit të datës 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 08.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër dosjes së tenderit të datës 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se disa nga kërkesat e dosjes së tenderit duhet të ndryshohen pasi që si të tilla (sipas parashtruesit) ato janë në kundërshtim me parimin për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Duke u referuar te pretendimet e tij ankimore, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7 dhe 69 të LPP si dhe nenin 70 të RRPP.

Kërkesat e dosjes së tenderit kundër të cilave parashtruesi ka paraqitur pretendimet ankimore janë si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional:</b>	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare</b>
		2.Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqes. a) •Inxhinier i Arkitekturës 1, me master profesional për efieçncë energjetike me përvoj min. 7vite; •Inxhinier i elektros 1, me përvoj punë në këtë lami min. 3 vite të dëshmohet me referenca- të dorezohet diploma e inxhinierit e noterizuar; •Specialist i mjedisit 1, i kualifikuar si Inxhinier Ndërtimi, duhet te kete te pakten nje diplomë bachelor me min pesë vjet përvojë ne nje natyrë të ngjashme; •Inxhinier i diplomuar i makinerisë 1, me së paku 7 vite përvojë punë pas diplomimit, dhe të jetë i certifikuar në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë; •Inxhinier i diplomuar i makineris-me pervoj pune minimum 5 vite dhe të jetë i qertifikuar me standarde EN ISO 9606-1; •Inxhinier i mjedisit 1-ose bachelor - i certifikuar per Siguri dhe shëndet në punë.	2.Deshmit e kerkuara; Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi CV-ja ,diploma, Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. (Për stafin që nuk gjendet në marrëdhënie pune të ofrohet kontratë për angazhim në emër të projektit, kontrata duhet të jetë e noterizuar në mes të Inxhinierit dhe Punëdhënësit) -
		b)Punëtor të certifikuar •Nje suvatues I certifikaur •Nje fasader I certifikaur •Nje Moler I certifikaur •Nje shtrues pllakash I certifikaur •Nje Hidroinstalues i certifikaur •Nje Instalues I ngrohjes qendrore I Certifikaur •Nje elektro instalues I certifikaur •Nje Saldues i certifikaur •Nje punetori I certifikaur per pllaka gipsi për kryerjen e punëve në teren.	b) Duhet te drzohen kopjet e qertifikatve nse nuk jane staf i rregullt i Opertarove Eknomik duhet te dorzoj angazhimin e tyre mbi kete projekt
		c)•Punëtorë fizikë 30, të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë - duhet të dorëzohen marrëveshjet mbi angazhimin e tyre.	c)OE -ik duhet te dorzojne marrëveshjet mbi angazhimin e tyre.
		4.Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i produkeve për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 19.15, 26.5, 29.1, 29.11, , 30.1,	4.Kopja e Autorizimit te prodhuesit apo distributorit te Autorizuar.
		5.Katalogu nga prodhuesi me specifika për pozicionet 7.1, 7.2, 8.2, 8.3, 9.1, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 13.1, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 23.1, 23.2, 23.3, 23.4, 26.5, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 28.18, 29.1, 29.11, 29.14, 29.15, 30.1, 30.2.	5. Kopja e katalogut per pozicionet e kerkuara
	6.Garancioni minimum 1 vite nga prodhuesi për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7,16.10, 16.12, 26.5, 29.1, 29.11, 19.15, 30.1.	6. OE-ik duhet te ofroje nje deklarate te vulosur dhe nenshkuar per Grancionin nga prodhuesi min. 1 vite per poziocinet e kerkuara .	

	7.Test Raporti për pozicionet 16.10 dhe 16.12 sipas standardit EN 12390-8 dhe ENEC cetrifika për pozicionin 26.5.	7.OE-ik duhet te dorzoj Test Raportin sipas standardit EN 12390-8 per pozicionet e kerkuara.
	8.Duhet të dorëzohen mostrat për produktet në pozicionet 7.2, 8.3, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7,12.1, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18,13.1, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 23.1, 23.2, 23.3, 23.4, 24.5, 26.5, 26.7, 26.8, 26.9, 26.10.	8. Mostrat duhet te dorzohen ne ditën hapjes se ofertave para ores 13 30 ne Sektorin e Prokurimit - (Komuna Vjeter).
	9.Duhet të dorëzohen ISO certifikatat nga prodhuesit e produkteve per pozicionet 7.1, 7.2, 8.2, 8.3, 9.1, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 13.1, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 28.18, 29.1, 29.11, 29.14, 29.15, 30.1, 30.2.	9.Kopjet e qertifikates per pozicionet e kerkuara.
	10.Duhet të dorëzohen DoP(Declaration of performance) nga prodhuesit e produkteve per pozicionet 7.2, 8.2, 8.3.	10.OE-ik duhet te dorzoj DoP(Declaration of performance) nga prodhuesi per produktet per pozicionet 7.2, 8.2, 8.3.
	11.Duhet të dorëzohen CE certifikatat nga prodhuesit e produkteve per pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 29.1, 29.11, 29.15, 30.1, 30.2.	11.Kopjet e qertifikates per pozicionet e kerkuara.

Konkretisht pretendimet ankimore të parashtruesit janë formuluar si në vijim:

**Pika ankimore nr. 1** - *“Tek kërkesa Inxhinier I Arkitektures 1 , master profesionale per eficience energjetike – Kekesa shtese e specifikuar qe te ket master per eficence energjetike eshte e pa arsyeshme. Sipas LPP dhe RRUPP lejohet qe per ta argumentuar se stafi profesional I cili dote angazhohet per realizim te kontrates ne kete rast Inxhinier I Arkitektures mjafton qe te posedojne vetem titullin Inxhinier I diplomuar, ose nese eshte Bachelore atehere lejohet qe te kerkohet titulli Master I diplomuar I arkitektures. Kerkese qe te kete minimum master profesional per eficience engjetike eshte jo ligjore, ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP, favorizuese per nje OE te veqant, dhe diskriminuese ndaj OE tjere. Andaj kerkojme qe ixhinieri I diplomuar I arkitektures te jete me titull Inxhinier I diplomuar ose nese eshte Bcelore Master diplomuar Arkitektures dhe kerkojme qe te eliminohet kërkesa shtese ku specifikohet qe te jete me master profesional per eficience engjertike. Pasiqe mjafton Inxhinieri ta posedoje Titullin Inxhinier I Arkitektures”.*

**Pika ankimore nr. 2** - *“Tek kërkesa Inxhinier I Elektros 1 te jete auditor I energjise I certifikuar me standartet En 16247 ne ndriqim publike. Po ashtu te kete te perfunduar stutimet min nivelin master ne eficience te energjise dhe te kete pervoje ne auditime te enegjerise te sepcifikuar. Kerkese qe te kete minimum master profesional per eficience engjetike dhe te jet auditor I energjisise I certifikuar me standartet EN 16247 ne ndriqim publike eshte jo ligjore, ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP, favorizuese per nje OE te veqant, dhe diskriminuese ndaj OE tjere. Andaj kerkojme qe te eliminohet kufizimi min niveli I master dhe te eliminohet percaktimi I titullit vetem master I eficencen se energjesi , Po ashtu kerkojme qe te eliminohet kërkesa e Cerfikates EN 16247 ne ndriqim public. Gjithashtu kerkojme qe te eliminohet kërkesa qe te kete pervoje pune ne auditime te energjisise te specifikuar”.*

Faqe 3 nga 8

**Pika ankimore nr. 3** – “Tek kërkesa Nje Inxhinier I diplomuar Makinerise me 5 vite pervojje pune dhe te jete I certifikuar me standard En Iso 9606-1, Paraprakisht eshte kerkuar nje inxhinier I makinerise te cilet mbulohen menaxhimin e puneve te makinerive gjate egzekutimit, dhe sipas LPP dhe RRUPP kërkesa me certifikata trajnimi ISO jane ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP. Kërkesa qe te jete I certifikuar me standart EN ISO 9606-1 per kërkesa tilla si OE posedojme Vendim nga OSHP. Kjo kërkesë është e pa nevojshme dhe e pa arsyeshme, pa nevojshme, favorizuese per nje OE ,diskriminuese ndaj OE , dhe kufizon konkurrencen. . Andaj kerkojme qe te eliminohet si kërkesë komplet”.

**Pika ankimore nr. 4** – “Tek kërkesa Nje Inxhinier Mjedisit ose Bachelore. Qe te konstatohet qe projekti dhe specifikacioni I pershkrimtit te puneve ne paramase dhe parallogari jane ne pajtueshmeri me mbrotjen e mjedisit atehere kjo procedure eshte ne fazen e projektimit dhe perpilimit te paramases dhe parallogarise. Andaj kerkojme qe te eliminohet komplet si Kërkesa Nje inxhinier I Mjedisit ose Bachelore dhe eliminohet kërkesa qe te jete I certifikuar per siguri dhe shendet ne pune nga Agjencia per menaxhimin e emergjencave. Argumente ligjore per piken ankimore nr 1 deri nr 6 sipas tabelës Kriteret e perzgjedhjes per punet ndertimore”.

**Pika ankimore nr. 5** - “Tek kërkesa b te kërkesa 9.1 dhe 9.2 FTD keni kerkuar Nje suvatures I certifikuar, Nje fasader I certifikuar, Nje moler I certifikuar, Nje shtrues pllakash I certifikuar, Nje Hidroinstalues I certifikuar, Nje instalues I ngrohjes qendrore I certifikuar, Nje elektro instalues I certifikuar, Nje saldues I certifikuar, Nje pllaka gipsi per kryere puneve ne teren I certifikuar. Keto kërkesa jane ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP, jane kërkesa favorizues ndaj nje OE veqant, jane diskriminuese ndaj OE, zvoglohet konkurrenca etj. Ju si AK jeni duke bere diskriminim ndaj kompanive te cilet posedojne mjeshtrit e profesioneve te kerkuar te cilet posedojne pervojje pune me referenca nga punedhesi, duke paguar edhe tatim dhe kontributet per punen e tyre. Sipas RRUPP dhe LPP lejohet vetem Lista mesatare e tri viteve te fundit te punesuarëve nga kompania. Ne asnje rrethane nuk pershkruhet ne LPP dhe RRUPP qe stafi - mjeshtrit duhet te deshmojen me certifikata zanatit. Andaj ne si OE kerkojme qe certifikatat e kerkuara per mjeshtrit te eliminohen ose kerkojme qe te lejohet qe OE konkurrues te ofrojne mjeshtrit me pervojje pune edhe pa certifikata te zanatit. Nese nuk e posedon nje Certificate zanatit nuk dote thote se nuk je mjeshter nese e praktikon at profesion dhe ka deshmi reference nga punedhënesi dhe ka paguar tatim dhe kontribute sipas Ligjit”.

**Pika ankimore nr. 6** – “Ne piken c) keni kerkuar pune fizike 30 te trajnuar per siguri dhe shendet ne pune, Kjo kërkesë është ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP pasi qe ne asnje rrethane nuk specifikohet kërkesa te tilla. Eshte kërkesë diskriminuese ndaj OE, kërkesë 6/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK qe favorizon per nje OE veqant, zvoglon konkurrencen. 3 Sipas LPP dhe RRUPP eshte parapare vetem nje Liste te punetoreve mesatare te punesuarëve. Sic eshte parapare siguria ne punishte sipas nenit 13 ne kushtet e pergjithshme kontrates dhe neni 11.2 Kushteve te veqanta te kontrates. Andaj me nenin 13 KPK dhe neni 11.2 KVK OE e bejne sigurine ne pune edhe pa pasur punetoret fizike te trajnuar ne siguri dhe shendet ne pune po ashtu bejne sigurimin e shendet me police sigurimi gjate egzekutimit. Kerkojme qe te eliminohet qe punetoret fizike te jene trajnuar per siguri dhe shendet ne pune”.

**Pika ankimore nr. 7** – “Si OE konsiderojme se kërkesa ne piket 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 jane te pa nevojshme, te pa arsyeshme ne kete faze te aktivitetit te prokurimit dhe mund te konsiderojme se ky aktivitet mund te jete pergatitur per ndonje OE te veqant per ty pergatitur per kete aktivitet spese: Eshte e pa nevojshme sepse gjate realizimit te kontrates prodhuesi mund te mbyllet kompanine, ose ti terheqe keto produkte nga prodhimi te cilet jane kerkuar. Ose mund te ia terheqe autorizimin distributorit. Atehere momentin qe ndodhin keto gjera OE kontraktues I kontrates eshte I obliguar qe ti zevendesoje keto produkte me ndonje prodhues tjerter. Ndersa sipas kontrates kushtet nuk mund te ndryshohen gjatee realizimit. Keni kerkuar garacion nga prodhuesi se paku nje vite ndersa kërkesa e puneve garatuese pas pranimit te puneve nga ana juaj si AK-se eshte minimum 3 vite deri 10 vite. Sipas kushteve te kontrates pas pranimit te punëve periudha garatuese e puneve te realizura OE kontraktues ose I ndalet vlera e mejteve monetare ose ofron police sigurimi per periudhen garatuese. Ne KPK dhe KVP eshte specifikuar qarte se si duhet te realizohet kontrata duke filluar nga aprovimet dhe deri ne pranimin perfundimtare te punimeve, periudhen garatuese te punimeve te ekzekutuara etj.. Edhe sipas RRUPP neni 70.5 me nenshkrimin e kontraten kompetencat ligjore per menaxhim te kontraten dergohen tek menaxheri I kontrates, po ashtu ne piken 70.23 RRUPP sqarohen qarte kompetencat ligjore te menaxherit te kontrates dhe organit mbikeqyres. Ne si OE konsiderojme se per kërkesat te paraqitura ne piken 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 dhe puneve tjera te pershkruara ne paramase dhe prallogari qe OE konkurrues deklararon me nje deklarate se I kupton specifikat e puneve te pa parapara, se i pranon dhe se dote permbushe kontrates sipas specifikimeve teknike per secilin pozicion te parashikuar ne oferten financiare. Sigurimi I dokumentave dhe dorezimi I mostrave per OE konkurrues eshte kosto shtese e pa arsyeshme. Andaj 7/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK kerkojme qe te eliminohen kërkesa ne piket 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 duke ofruar dokumente si autorizimet, garacionet, atestet, certifikatat Iso, mostrat e produktit pasiqe jaen te pa arsyeshme dhe te pa nevojshme, favorizuese dhe mostrat e produktit pasiqe dorezimi i mostrave te produktit per OE eshte kosto shtese e pa arsyeshme, po ashtu sipas RRUOPP per punet ndertimore nuk eshte parapare qe duhet te dorezohen ateste, certifikatat, autorizimet, mostrat e produktit etj por lejohet vetem per aktivitetet e furnizimeve”.

**Pika ankimore nr. 8** – “Ne Listen e paisjeve ka paisje qe nuk jane te nevojshme te pa arsyeshme dhe argumenti I ture me dokumenta eshte e pa nevojshme pasiqe sipas tabelese se kritereve tek Udhezuesi specifikohet se duhet te jene kërkesa minimale per veglat, po ashtu si deshmi mjafton nje dekrata te veglave qe OE kontraktues dote kete ne dispozicion per ta realizuar kontraten”.

**Pika ankimore nr. 9** – “Tek kërkesa Specialist I mjedisit I I kualifikuar si Inxhinier Ndertimi duhet te ket se paku diplome Bachelor, Ne piken a keni kerkuar Nje inxhinier I ndertimtarise – Konstruktive qe te jete menaxher I kontrates. Qe mjafton nje inxhinier I ndertimtarise-drejtimi konstruktive per realizimin e kontrates. Kjo kerkese eshte e pa nevojshme dhe e pa arsyeshme, pa nevojshme, favorizuese per nje OE diskriminuese ndaj OE, dhe kufizon konkurrencen. Andaj kerkojme qe te eliminohet komplet Kërkesa Nje spacialit I mjedisit kualifikuar si Inxhinier I ndertimit I certifikuar si specialist mjedisit pasie ne kërkesen a eshte kerkuar nje inxhinier I ndertimtarise-konstruktive qe mbulon mbikeqyrjen per punet ndertimore gjate ekzekutimit te puneve”.

**Pika ankimore nr. 10** – *“Tek kërkesa Nje Inxhinier I diplomuar Makinerise 1 Te jete I certifikuar ne lemin e mbrotjes nga zjarri dhe I certifikuar per siguri dhe shendet ne pune. Kjo kerkese e pa nevojshme dhe pa arsyeshme, diskriminuese ndaj OE dhe favorizuese ndaj nje OE te veqante dhe ne kundërshtim me LPP dhe RRUPP. Sipas LPP dhe RRUPP per stafin profesional qe dote angazhohet ne projekt kerkohet dokumente CV, Referenca nga punedhesi per pervojen e punes dhe diplomave e shkollimit. Certifikata trajnime nje ditore nuk jane parashikuar ne LPP dhe RRUPP. Po ashtu rreth sigurise ne pune edhe nese e posedon por edhe nese nuk e posedon me certifikata te tilla OE kontraktues se kontrates sipas nenit 13 Siguria ne Vendpunishte ne Kushtet e Pergjithshme te kontrates eshte I obliguar qe ti ofroje sigurine ne punishte”.*

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 14.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Fillimisht duhet cekur që sipas pretendimeve ankimore kërkohet që të ndryshohen ose largohen mbi 80% e kërkesave të dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Pra nuk bëhet fjalë për një kërkesë të caktuar ose dy ose tri por bëhet fjalë për shumicën absolute të kërkesave lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Përmes nenit 60 paragrafit 60.3 nënparagrafi f) të RRPP përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet edhe të *“përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar”*. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur që të përshkruaj rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar. Rrjedhimisht është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 60 paragrafin 60.3 nënparagrafin f) të RRPP. Kjo për arsye se formulimet e parashtruesit në shumicën e rasteve nuk janë as të kuptueshme në aspektin gjuhësor dhe as të logjikshme në aspektin juridik. Pavarësisht këtij fakti, lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të rivlerësojë nëse kërkesat në dosjen e tenderit janë në përputhje me LPP. Rrjedhimisht me njësia kërkuese është përgjigjur ashtu që nuk ka gjetur mospërputhje mes kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP.

Vlen të shtohet po ashtu me datën 07.08.2023 është ndryshuar dosja e tenderit. Rrjedhimisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruar e datës 08.08.2023 nuk i referohet dosjes së ndryshuar të datës 07.08.2023 por dosjen paraprake të tenderit. Në këtë mënyrë si shembull pretendimi i dytë i parashtruesit është i paarsyeshëm sepse kërkesa e tillë tanimë është ndryshuar përmes dosjes së tenderit.

Për Autoritetin Kontraktues është e domosdoshme që ky aktivitet i prokurimit të realizohet me sukses ashtu që projekti të implemetohet në mënyrë profesionale, me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare.

Në rastin konkret parashtruesi ka pretenduar që kërkesat janë në kundërshtim me parimin për mos diskriminim/favorizim në kuptim të nenit 7 të LPP. Në këtë rast

parashtruesi është dashur që krahas pretendimeve të paraqet edhe argumentet e tij se këto kërkesa është vështirë që të përmbushen nga tenderuesit. Në pothuajse të gjitha pretendimet parashtruesi vetëm ka thënë se "këto kërkesa janë të panevojshme". Në anën tjetër parashtruesi ka dorëzuar pretendime ankimore për shumicën e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Kjo nënkupton që sipas parashtruesit shumica e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale janë të panevojshme rrjedhimisht duhet të largohen ose të paktën të ndryshohen. Pra qysh në vështrim të përgjithshëm pretendimet e parashtruesit janë kundërthënëse dhe të palogjikshme për faktin se Autoriteti Kontraktues nuk mund të largoj shumicën e kërkesave mbi mundësitë teknike ose profesionale sikurse pretendon parashtruesi.

Përmes nenit 10 par. 10.1 nënparagrafi b) të RRPP është përcaktuar se njësia e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të "Përgatit/proponon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasën dhe Paralogarinë". Në rastin konkret njësia kërkuese ka përgjegjësinë e plotë për paramasën sipas dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit.

Sa i përket pretendimeve ankimore me rastin e sigurimit të përgjigjes së cituar më sipër nga njësia kërkuese, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përmbushur përgjegjësitë e tij në kuptim të nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP ku përcaktohet se zyrtari i prokurimit "në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet".

Nga sa u tha më sipër, lidhur me pretendimet ankimore zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përgjigjes së njësive kërkuese të cituar më lartë.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 14.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.